



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. regjistri 18/2020 (JR)
Datë 02.06.2020

Vendim nr. 43 (JR)
Datë 15.11.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 15.11.2022, ditën e martë, ora 14:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me sekretare gjyqësore Ina Xhetani, vendimin për çështjen e juridiksionit të rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Hajrie Muçmata, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër.

OBJEKTI I ANKIMIT: Shqyrtimi i vendimit nr. 209, datë 11.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim Kushtetuta), ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, nenet 6, 7, 8, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane të Drejtave e Lirive të Njeriut.

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit dhe avokatja e saj, të paraqitura në ankim, në parashtrime dhe në seancë gjyqësore publike, e me anë të të cilave kërkoi çeljen e hetimit gjyqësor për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe në vlerësimin e provave të reja, duke kryer një analizë të re financiare, vlerësimin për dy kriteret e tjera dhe, përfundimisht, prishjen e vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë në prezencë të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Hajrie Muçmata, (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Apelit Shkodër. Ajo i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës.
2. Bazuar në pikën 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, pas administrimit të raporteve të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, (në vijim “ILDKPKI”) dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, (në vijim “DSIK”), sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, (në vijim “Komisioni”), vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit bazuar vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë.

2.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar¹, duke konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) ka kryer deklarim të rremë; dhe (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 209, datë 11.11.2019, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Hajrie Muçmata. Në konkluzionin e përfundimtar, bazuar në problematikat e konstatuara për dy pasuri dhe në vijim të analizës financiare të kryer, Komisioni u shpreh se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme për kontrollin e pasurisë, nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së saj dhe të personave të lidhur, sipas parashikimeve të paragrafëve 1 dhe 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë. Nga analiza financiare e kryer në Komision, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme të të ardhurave për të krijuar pasuritë dhe për të kryer shpenzimet, për periudhën 2003-2016, duke pasur mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën prej (-) 6.417.174 lekësh.

III. Shkaqet e ankimit

4. Në datën 22.05.2020, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim kundër vendimit objekt shqyrtimi, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, (në vijim “Kolegji”), për aspekte procedurale dhe për themelin, siç parashtrihen më poshtë. Më tej, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në

¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 28.02.2018.

Kolegj parashtrime dhe kërkime shtesë me shkrim, që mbajnë përkatësisht datat 09.06.2022 dhe 18.10.2022. Në vijim, në mënyrë të përmbledhur, pasqyrohen kërkimet e subjektit të rivlerësimit dhe parashtrimet e aktet e sjella prej saj.

A. Parashtrimet në ankim

5. Lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:

5.1. Vendimi objekt shqyrtimi është absolutisht i pavlefshëm, referuar dispozitave të neneve 4, 15 e 42, pika 2 e Kushtetutës, neneve 57 e 66, pika 1, germa “c” të ligjit nr. 84/2016, neneve 119, 121, 123, 308, 310, 466, germa “ç” dhe 467 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe vendimit unifikues nr. 2, datë 24.01.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi duhet të priset dhe çështja të kthehet për rigjykim, për shkak se nuk është nënshkruar nga relatorja, ndërsa është e paqartë nëse relatorja ka firmosur vendimin e marrë në dhomën e këshillimit dhe shpallur në seancën dëgjimore.

5.2. Përbërja e trupës gjyquese të Komisionit ka qenë e parregullt, relatorja nuk përmbushte kriteret për ta hetuar, gjykuar e shkarkuar subjektin nga detyra, në kushtet kur ajo vetë ishte shkarkuar nga detyra për shkelje të ligjit dhe paaftësi, referuar vendimit nr. {***}, datë 23.08.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”).

5.3. Komisioni nuk ka dhënë garancitë procedurale të garantuara nga Kushtetuta, ligji nr. 84/2016 dhe të ligjit nr. 44/2015, për një gjykim të drejtë, të barabartë, të pavarur dhe të paanshëm, në këto kushtet Komisioni ka refuzuar riçeljen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera, atë të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe në kushtet kur procedura e hetimit administrativ është kryer e gjitha nga të njëjtët anëtarë.

5.4. Komisioni ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit, referuar Kushtetutës, nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim, KEDNj), vendimeve nr. 20/2012 dhe nr. 38/2010 të Gjykatës Kushtetuese dhe jurisprudencës² së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim, GjEDNj), pasi vendimi objekt shqyrtimi, përmban një sërë gabimesh, nuk jep informacion mbi faktet që qëndrojnë në themel të procesit, përmban informacione të pavërteta mbi procedurën e ndjekur, referon në konkluzione të cilat nuk i janë komunikuar subjektit, si në shuma monetare dhe në tabela krejtësisht të ndryshme në krahasim me rezultatet e hetimit.

6. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar sa vijon.

6.1. Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 117,5 m², në rrugën “{***}”, pallati {***}, Tiranë³, ka deklaruar saktë, në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2004, sipërfaqen e pasurisë prej 126 m² dhe që çmimi i blerjes që fillimisht ka qenë 33.000 euro, i cili pas punimeve shtesë të kryera u shtua në 36.425 euro [e konvertuar në lekë 4.462.000 lekë].

6.1.a. Kontrata e sipërmarrjes nuk ka modalitetet e një akti zyrtar. Me *moment prenontimi*, si kohë të pagesës, ka konsideruar vitin financiar të deklarimit të pasurisë [2004] dhe jo një datë konkrete. Kësti i fundit u pagua me përfundimin e pallatit.

6.1.b. Për sa i përket burimit të krijimit, në muajin prill 2004, ka paguar këstin e parë të çmimit të apartamentit në vlerën prej 26.200 USD me kursimet e vitit 2003 që kishte në banesë dhe në dhjetor 2004 ka kryer pagesën e vlerës në total prej 33.000 eurosh nëpërmjet huas nga E. B..

² Hadjianastassiou kundër Greqisë (1992) dhe Hirvisaari kundër Finlandës (2001).

³ Blerë në datën 12.04.2006, me vlerë 4.562.000 lekë³ [kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol.].

6.2. Për sa i përket pasurisë “njësi shërbimi”, me sipërfaqe 117 m², të blerë në datën 30.12.2016, me vlerë 29.000 euro⁴, në bashkëpronësi me N. D., nuk e ka deklaruar porositjen e kësaj pasurie në deklaratën fillestare të pasurive 2003 dhe në deklaratën periodike/vjetore 2004, meqenëse në këto vite nuk kishte kryer asnjë pagesë dhe, rrjedhimisht, nuk ka pasur asnjë të drejtë reale. Pjesa takuese është deklaruar në deklaratën e interesave periodike/vjetore 2006, ndërsa sipërfaqja e deklaruar në deklaratën *vetting* ka qenë gabim material.

6.2.a. Nuk ka deklaruar në deklaratën periodike/vjetore 2006 huan prej 3.000.000 lekësh nga Sh. B., meqenëse ishte marrë dhe shlyer brenda vitit 2006 dhe, rrjedhimisht, nuk ka ndikuar në shtesa dhe pakësim të pasurisë.

6.2.b. Pagesën e kështit të parë në vitin 2003 e ka kryer bashkëpronari N. D., ndërsa pjesa takuese e saj dhe personit të lidhur është paguar në vitin 2006.

6.3. Analiza financiare sipas vendimit objekt shqyrtimi, me balancë negative 6.417.174 lekë, është e ndryshme nga analiza financiare sipas rezultateve të hetimit, datë 04.10.2019, e cila pasqyron një balancë negative prej 4.796.614 lekësh. Vendimi është i paarsyetuar dhe nuk qartësohet konkluzioni i arritur mbi balancën negative.

6.3.a. Subjekti i rivlerësimit ka kontestuar mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës nga Komisioni, si dhe shpenzimet e udhëtimeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, që kanë rezultuar nga sistemi referues i Policisë së Shtetit [në vijim sistemi *TIMS*].

6.3.b. Komisioni nuk ka përfshirë të ardhurat e personit të lidhur, bashkëshortit, në periudhën kohore janar-mars 1995, sipas shkresës zyrtare të dërguar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës (DRSSh Kukës).

B. Parashtrimet e datës 09.06.2022

7. Duke konfirmuar sa ka argumentuar në ankim, në këto parashtrime, subjekti i rivlerësimit u fokusua në aspekte të vendimit që në këndvështrimin e saj përbëjnë shkelje të procesit të rregullt. Këto pretendime kryesisht bazohen në praninë dhe pjesëmarrjen e komisioneres A. F. në trupin gjykues, që kreu rivlerësimin e saj në Komision. Subjekti sjell në vëmendje që relatorja e trupi gjykues në Komision, komisionerja A. F., është shkarkuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në vitin 1996. Ky fakt, që subjekti referon se nuk është deklaruar nga znj. F., e vendos këtë të fundit në kushtet e pazgjedhshmërisë.

7.1. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar kallëzim penal pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për këtë komisionere, nisur nga çështja penale në ngarkim të anëtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, z. L. D.. Meqenëse prokuroria ka pushuar çështjen penale dhe të dy gjykatat kompetente kanë lënë në fuqi vendimin e prokurorisë, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji *pezullimin* e shqyrtimit të çështjes së saj në Kolegji, në kushtet kur ajo ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të dy gjykatave më të ulëta. Subjekti ka bashkëlidhur tri akte në mbështetje të këtij aspekti të parashtrimeve të saj: (i) vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GjKKO), që vendosi të pranojë pushimin e çështjes penale të iniciuar prej saj [vendimi nr. {***}]; (ii) rekursin e ushtruar nga subjekti i rivlerësimit në datën 18.08.2021, kundër vendimeve të dy gjykatave; si dhe (iii) të dhëna të gjeneruar prej faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, që konfirmon regjistrimin e rekursit.

⁴ Ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, të porositur në datën 05.11.2003 dhe blerë me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.12.2016.

7.2. Në këto parashtrime, subjekti i rivlerësimit paraqiti, po ashtu, 5 (pesë) akte të reja në cilësinë e provës⁵. Sipas saj, këto akte janë gjetur vetëm pasi bashkëpronari me personin e lidhur, bashkëshortin, N. D., ka ndërruar jetë. Sipas këtyre akteve, të cilat subjekti i rivlerësimit argumenton se ka qenë në pamundësi të paraqiteshin gjatë procesit të hetimit administrativ, provohet që dy pagesat e para për njësinë, në vlerën në total prej 30 mijë eurosh, janë kryer nga i ndjeri në tetor dhe nëntor 2003, ndryshe nga sa është konstatuar në vendimin objekt shqyrtimi. Sipas këtij kalendari pagesash, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kryer pagesa këstesh vetëm në vitin 2006, përkatësisht në 26 maj dhe 11 qershor. Subjekti argumenton se këto akte, ekzistenca e të cilave i është bërë e njohur vetëm pasi N. D. ka ndërruar jetë, hedhin poshtë qëndrimin “dashakeqës”⁶ të vendimit të Komisionit, për sa ka konkluduar për bashkëpronësinë.

7.3. Së fundmi, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit⁷, referuar dy paragrafëve që fokusohen në metodologjinë e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës deri në vitin 1999, si dhe pagesës së detyrimeve tatimore gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit kërkon përsëritjen e analizës financiare, pretendon se Komisioni nuk ka përlllogaritur të ardhurat e personit të lidhur në periudhën 1983-1994 dhe thekson që tatimet nga qiratë e përfituara kanë qenë detyrim i qiramarrësve dhe përbëjnë të ardhura të përfituara realisht prej saj. Sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë sa provon vërtetimi nga administrata tatimore Kukës, për pagesën e tatimeve për fitimet që lidhen nga kontrata e qirasë e datës 31.12.2008⁸.

8. Subjekti i rivlerësimit thekson se shkak kryesor i ankimit të ushtruar prej saj është të shpallet *pavlefshmëria absolute* e vendimit të marrë për shkarkimin e saj, meqenëse mungon vullneti i relatores, e cila nuk ka nënshkruar apo arsyetuar vendimin që lidhet me rivlerësimin e saj. Duke referuar se ka qenë e paqartë në kërkimet e mëparshme, subjekti kërkon që bazuar në jurisprudencën e Kolegjit⁹ dhe cituar paragrafin në të cilin konstatohet shkelja e garancive procedurale, për shkak të mungesës së nënshkrimit, çështja e saj të kthehet për rishqyrtim në Komision.

C. Parashtrimet e datës 18.10.2022

9. Në datën 18.10.2022, subjekti i rivlerësimit përcolli në Kolegjin parashtrime të tjera me anën e të cilave, duke theksuar sërish shkaqet kryesore të ankimit, në ndryshim nga parashtrimet e sipërcituara, të muajit qershor 2022, kërkoi: (i) riçeljen e hetimit për kriterin e pasurisë dhe vlerësimin e provave të reja; (ii) vlerësimin për dy kriteret e tjera; si dhe (iii) prishjen e vendimit të Komisionit që vendosi shkarkimin e saj dhe konfirmimin në detyrë.

9.1. Në këto parashtrime, pasi theksoi që nga ana strukturore ankimi përbëhet nga shkaqet që përbëjnë bazë për pavlefshmërinë absolute të vendimit, për shkak të pranisë së Komisioneres A. F. në përbërje të trupit gjykues dhe shkarkimit të saj të mëhershëm nga detyra si gjyqtare, që përbën shkelje të procesit të rregullt për shkak të përbërjes së trupit gjykues dhe ato që lidhen me pasurinë, subjekti, bazuar edhe në vendime të Kolegjit, fokusohet në sipërfaqen e njëres prej pasurive, për të cilat Komisioni ka gjetur probleme dhe bazuar në konkluzionet në vlerësimin e pasurisë, problematikat në lidhje me çmimin, si dhe argumente të tjerë, të cilët gjejnë pasqyrim në shkaqet e ankimit, përmbledhur më sipër.

⁵ Deklaratë noteriale e datës 07.06.2022 e H. D., bashkëshorte e të ndjerit N. D., dy mandatearkëtimi që mbajnë respektivisht datat 27.10.2003 dhe 05.11.2003, për shumat 3.690 euro dhe 26.310 euro, nga N. D., dhe mandatararkëtimi i datës 11.06.2006, për shumën 9.500 euro, nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit I. M. [bashkëshorti].

⁶ Faqe 3 e parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit që mban datën 09.06.2022.

⁷ Vendimi nr. 15/2012, që lidhet me subjektin e rivlerësimit K. Selita.

⁸ Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës, që ndonëse subjekti e referon t'i përkasë vitit 2012, është saktësuar nga dërguesi se i përket shkurtit 2013.

⁹ Vendimi i Kolegjit (JR) nr. 28/2021, që lidhet me subjektin e rivlerësimit A. Vrioni.

9.2. Së fundmi, subjekti në këto parashtrime ritheksoi vlerën provuese të akteve të reja të paraqitura prej saj në parashtrimet e qershorit 2022 [shih paragrafin 7 dhe nënpjesët e tij], për të kërkuar kryerjen e një analize të re financiare, meqenëse mandatarkëtimet, e sjella prej saj rishtazi, provojnë se ajo dhe personi i lidhur kanë shpenzuar për pasurinë disa vite më pas, përkundër sa është konkluduar nga hetimi i kryer nga Komisioni.

D. Parashtrimet në seancën publike në Kolegj

10. Siç shtjellohet në vijim, në seancën publike të caktuar nga trupi gjykues i Kolegjit më 07.11.2022, subjekti i rivlerësimit paraqiti argumentet e saj referuar ankimit, shtjelluar në detaj më sipër, duke u fokusuar qoftë në argumentet me fokus garancitë për proces të rregullt, ashtu edhe ato që lidhen me themelin e vlerësimit të pasurisë.

10.1. Në lidhje me shkaqet me natyrë procedurale, përpos argumenteve nën dritën e Kodit të Procedurës Civile dhe atij të Procedurave Administrative, kryesisht në lidhje me mungesën e nënshkrimit të relatores në arsyetim, subjekti i rivlerësimit potencoi edhe faktin që sipas saj ka përbërë parregullsi të krijimit të trupit gjykues në Komision, për shkak të qenies së relatores/komisioneres A. F., në trupin gjykues dhe vendimit të marrë nga KLD-ja për shkarkim e saj në vitin 1996. Duke referuar vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim, GjEDNj), në çështjen Besnik Cani kundër Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit argumentoi se vendimi i Komisionit për shkarkimin e saj ka qenë “nul” për shkak të paligjshmërisë në emërimin në detyrë të relatores.

10.2. Në lidhje me themelin e vlerësimit të kriterit të kontrollit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit u fokusua në të njëjtët aspekte dhe argumente të ngritura prej saj në ankim e në parashtrimet e mëparshme, përmbledhur më sipër në detaj në pjesët përkatëse.

10.3. Në përfundim, subjekti kërkoi: (i) çeljen e hetimit gjyqësor për kriterin e pasurisë dhe vlerësimin e provave të reja; (ii) vlerësimin për dy kriteret e tjera; si dhe (iii) prishjen e vendimit nr. 209/2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion [*ratione materiae*] për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, për rivlerësimin e subjekteve të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

12. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit¹⁰, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 e ligjit nr. 84/2016.

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në Kolegj, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Edhe çështja objekt gjykimi u mor fillimisht në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, më datë 25.10.2022.

¹⁰ Vendimi i arsyetuar i Komisionit iu njoftua subjektit të rivlerësimit në datën 11.05.2020. Ndaj vendimit të arsyetuar është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit, protokolluar me nr. {***} prot., datë 22.05.2020 dhe pranuar nga Komisioni me vendimin nr. {***}, datë 26.05.2020.

13.1. Në vijim të shqyrtimit mbi bazë dokumentesh, trupi gjykues i Kolegjit vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me qëllim korrigjimin e gabimeve procedurale të kryera nga ana e Komisionit, parashikuar nga neni 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”¹¹. Trupi gjykues konstatoi nevojën e kryerjes së korrigjimeve procedurale të parashikuara nga neni F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për shkak të natyrës taksative të detyrimit të parashikuar për gjykatën që ushtron kontrollin mbi vendimin e një shkallë më të ulët nga neni 467, germa “b” e Kodit të Procedurës Civile, pasi konstatoi se në arsyetimin e vendimit objekt ankimi mungon nënshkrimi i një prej komisionerëve.

13.2. Seanca publike u zhvillua në datën 09.11.2022, në praninë e subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësueses së saj ligjore, avokates Irena Reso. Pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe avokaten, [shih parashtrimet në nënpjesën D, paragrafi 10 dhe nënparagrafët e tij], trupi gjykues vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të marrë në cilësinë e provës aktet e sjella bashkëlidhur ankimit të datës 22.05.2020 dhe parashtrimeve të paraqitura në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit në datën 13.06.2022. Po ashtu, trupi gjykues vendosi të administrojë si provë edhe 6 (gjashtë) fotografi të depozituara prej subjektit të rivlerësimit gjatë seancës publike, që lidhen me një prej pasurive të deklaruara prej saj.

13.3. Nga ana tjetër, trupi gjykues refuzoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit të Komisionit, në kushtet kur kërkimet në këtë drejtim do të zgjidhen nëpërmjet vendimit përfundimtar të Kolegjit. Po ashtu, trupi gjykues refuzoi kërkesën për pezullimin e gjykimit në Kolegj, pasi në kuptim të nenit 297 të Kodit të Procedurës Civile zgjidhja e çështjes objekt shqyrtimi mund të kryhet pavarësisht zgjidhjes së çështjes penale, mbi rekursin e ushtruar nga subjekti i rivlerësimit¹².

13.4. Së fundmi, trupi gjykues i bëri me dije subjektit të rivlerësimit që kryerja e një analize të re financiare është pjesë e shkaqeve të ankimit. Si e tillë, analizën e kryer në përgjigje të kërkimeve të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues ia nënshtroi vendimmarrjes përfundimtare, të pasqyruar në vijim në detaj, në këtë arsyetim.

B. Mbi shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

- 14.** Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi objekt shqyrtimi është i cenueshëm, pasi në vendimin e arsyetuar mungon nënshkrimi i relatores. Subjekti vë në dyshim, po ashtu edhe nëse relatorja ka nënshkruar vendimin e shkurtër të marrë nga trupa gjyqësore e Komisionit në dhomë këshillimi dhe të shpallur në seancë dëgjimore. Siç shtjellohet më sipër në këtë vendim, lidhur me formën e gjykimit, trupi gjykues konstatoi se procesi i kryer në Komision, për shkak të mungesës së nënshkrimit të njëres prej komisionerëve në arsyetim, do të duhet të korrigjohej nga Kolegji nën dritën e nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për shkak të detyrimit të shprehur që vjen nga neni 467, germa “b” e Kodit të Procedurës Civile, zbatuar përkatësisht për qëllimet e procesit të rivlerësimit. Ky konstatim i rrethanave të faktit ishte një ndër arsyet për të cilat shqyrtimi u krye në seancë publike, në prani të subjektit të rivlerësimit. Pretendimet e tjera të subjektit, në drejtim të dyshimeve për praninë e relatores në bisedime, u gjetën të pabazuara. Konkretisht, nga procesverbali i vendimmarrjes datë 08.11.2019 dhe i konfirmuar nga procesverbali i shpalljes së vendimit, datë 11.11.2019, rezulton se relatorja ka qenë e pranishme në marrjen dhe shpalljen e vendimit përfundimtar të Komisionit.

¹¹ “1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: [...] b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkëlqje të rënda procedurale apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë [...]”.

¹² Referuar më sipër në paragrafin 7.1. çështja e regjistruar në Gjykatën e Lartë.

14.1. Nga aktet në fashikull rezulton që, për arsye objektive shëndetësore, relatorja e ka pasur të pamundur të nënshkruajë arsyetimin e plotë. Trupi gjykues i Kolegjit, si edhe në një çështje të mëparshme, që paraqiste situatë të njëjtë, parë nën dritën e dispozitave procedurale civile¹³, mbi bazën e nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës¹⁴, kreu një kontroll tërësor dhe shterues të vendimit objekt ankimi, si nga ana procedurale, ashtu edhe për nga themeli. Për rrjedhojë, procesi gjyqësor i kryer në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, mbi bazën e ankimit të subjektit të rivlerësimit, që përfshin, ndër të tjera, kontrollin e vendimit të marrë nga Komisioni dhe një analizë të plotë e gjithëpërfshirëse të akteve në fashikull dhe atyre të përcjella nga subjekti i rivlerësimit në parashtrime dhe në seancë, plotëson garancitë të cilat ligjbërësi i ka sanksionuar palëve në procedurë, qoftë në procesin e rivlerësimit kalimtar, qoftë edhe në këndvështrim të drejtave procedurale civile që rregullon neni 467 i Kodit të Procedurës Civile.

14.2. Pretendimet e ngritura nga subjekti, lidhur me komisioneren F. dhe kushtet e zgjidhshmërisë së saj, trupi gjykues i Kolegjit i analizoi dhe vlerësoi në disa këndvështrime, nën dritën e garancive procedurale që gëzon subjekti i rivlerësimit, sipas legjislacionit shqiptar dhe jurisprudencën e GjEDNj-së, e konkretisht, ndër të tjera, çështjen *Astradsson* kundër Islandës dhe *B. Cani* kundër Shqipërisë. Në vijim të analizës së kryer, duke marrë në konsideratë rrethana konkrete faktike e ligjore, përfshirë sa rezulton nga aktet e sjella në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit, që lidhen me procesin gjyqësor penal të nisur prej saj, faktin që vendimi i Komisionit iu nënshtrua kontrollit të kryer nga Kolegji dhe testit të përshkruar nga vendimet e GjEDNj-së për mënyrën e emërimit të gjyqtarëve si garanci për procesin e kryer nga një gjykatë e pavarur dhe krijuar me ligj, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit janë të papazuara.

14.2.i Së pari, trupi gjykues sjell në vëmendje që edhe nëse do të pranohej apo prezumohej e provuar që një ndër komisionerët ka qenë në kushtet e pazgjedhshmërisë, vendimi i Komisionit iu nënshtrua kontrollit shterues të kryer në Kolegji, të shtjelluar në detaj, në këtë arsyetim në vijim. Në këtë kontroll, trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu një verifikim të pretendimeve të subjektit në raport me analizën financiare, bazuar në *rezultatet e hetimit administrativ* të kryer nga Komisioni, me të cilat subjekti është njohur dhe ka dhënë prapësimet e saj. Së dyti, siç shtjellohet gjerësisht më sipër, subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësueses së saj ligjore iu dha mundësia të debatonte në procesin gjyqësor publik në Kolegji të gjitha argumentet që ajo zgjodhi në mbrojtje të pretendimeve të saj. Trupi gjykues, po ashtu pranoi edhe aktet e sjella prej subjektit në cilësinë e provës. Një analizë e thelbit të tyre vijon në pjesët përkatëse të këtij arsyetimi.

14.2.ii. Në përmbledhje të sa më sipër, duke iu rikthyer këndvështrimit procedural, parë në drejtim të shërimit të problemeve të konstatuara edhe nga trupi gjykues i Kolegjit, argumentet e subjektit të rivlerësimit, për sa i përket procesit të rregullt, janë trajtuar, analizuar dhe shëruar. Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtat e saj për një zgjidhje efektive dhe proces kontradiktor. Vetë ekzistenca e Kolegjit si garancia gjyqësore fundore e procesit, sikurse edhe kontrolli i shtuar i vendimit të Komisionit, kryer nga Kolegji, për subjektin e rivlerësimit Hajrie Muçmata, vlerësohen se përbëjnë një garanci me efekt zgjidhjeje efektive shëruese të çdo defekti të pretenduar e konstatuar. Në këtë arsyetim, trupi gjykues mban në konsideratë sa ka konstatuar GjEDNj-ja në vendimin *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, për strukturën dhe rolin e përcaktuar Kolegjit nga Kushtetuta dhe ligji.

¹³ Vendimi nr. 28/2021 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 11.1.

¹⁴ “[...] 3. Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe, si i tillë, bazohet te kriteret e përcaktuara në këtë ligj [...]”.

14.2.iii. Sa më sipër, i qëndron edhe testit teorik të zhvilluar nga jurisprudenca e GjEDNj-së në dy çështjet e sipërcituara – *Astraðsson* dhe *Cani*¹⁵, nën dritën e nenit 13 të KEDNj-së për zgjidhjen efektive. Në kushtet kur kërkimet e subjektit të rivlerësimit, në tërësinë e tyre, kanë gjetur trajtim në analizën e detajuar dhe të pavarur të kryer nga trupi gjykues i Kolegjit dhe arsyetim në këtë vendim, nga një gjykatë e krijuar me ligj¹⁶, trupi gjykues i Kolegjit konsideron se të gjitha çështjet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit, në kontekstin e të drejtave procedurale [dhe zgjidhjes në themel, shtjelluar në vijim], i janë nënshtruar kontrollit gjyqësor dhe plotësojnë kriteret e një procesi që në tërësinë e tij është i rregullt.

14.2.iv. Duke abstraguar nga sa më sipër, si *obiter dictum*, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit që, në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t'i nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve edhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve pasqyroi vullnetin politik të përfaqësuar të shoqërisë shqiptare. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t'i paraprinte emërimit fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit, për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t'i lihej rastësisë do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Së fundmi, në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, sipas testit të vendosur nga GjEDNj-ja¹⁷, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Këto të drejta, në rrethanat konkrete, pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër, konsiderohen të adresuara nga kontrolli i gjithanshëm i vendimit të Komisionit, kryer në Kolegj.

14.3. Duke vijuar me pretendimet e tjera të subjektit të rivlerësimit për shkelje të parimeve të gjykimit të drejtë, meqenëse hetimi dhe shqyrtimi janë kryer nga i njëjti trup gjykues në Komision, trupi gjykues i Kolegjit, duke ritheksuar sa ka vlerësuar GjEDNj-ja në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*¹⁸, i konsideron këto argumente të ezauruara, trajtuara në detaj, dhe të papranueshme.

14.4. I njëjti qëndrim vlen edhe për pretendimin e subjektit për shkelje të të drejtës për proces të rregullt, meqenëse rivlerësimi i saj është kryer mbi bazën e njërit prej kriterëve, atë të kontrollit të pasurisë. Siç është theksuar nga trupa gjykues e Kolegjit, vazhdueshëm në vendime të mëparshme, kryerja e procesit të rivlerësimit mbi bazën e vetëm një kriteri, parashikohet shprehimisht nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016¹⁹. Kjo mënyrë funksionimi, e cila ka kaluar testin e kushtetutshmërisë dhe të përputhjes me garancitë e procesit të rregullt, sipas nenit 6 të KEDNj-së, në vijim të vendimit *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, përbën një rregullim ligjor që lejon efikasitetin, në kushtet kur konfirmimi në detyrë kërkon rezultat pozitiv për të tri kriteret nën

¹⁵ *Ky vendim i GjEDNj-së hyri në fuqi në datën 04.01.2023, pasi trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi ankimin e subjektit të rivlerësimit dhe mori vendimin mbi të cilin bazohet ky arsyetim. Shih <https://hudoc.echr.coe.int/fre?i=001-219773>.*

¹⁶ “Z” kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Ramirez Sanchez kundër Francës.

¹⁷ <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-206582>, paragrafi 221.

¹⁸ *Vendimi Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafët 307, 308 dhe 317, GjEDNj, ndër të tjera, ka konkluduar se mënyra e parashikuar nga ligji për kryerjen e rivlerësimit nuk përbën shkelje të nenit 6, pika 1 të KEDNj-së, sikurse edhe pasqyruar në analizën e kryer nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2/2017*

¹⁹ “[...] Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave [...]”.

dritën e nenit 59 pika 1 dhe mungesën e kushteve të cenimit të besimit të publikut, sipas pikës 2 të të njëjtës dispozitë.²⁰

C. Mbi shkaqet e ankimit për vlerësimin e pasurisë

15. Pasi ka hetuar për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni ka konstatuar probleme për dy nga pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur dhe në analizën financiare të kryer. Konkretisht, Komisioni e ka bazuar marrjen e masës disiplinore të shkarkimit për subjektin, bazuar mbi konkluzionet: për apartamentin me sipërfaqe 117,5 m², në rrugën “{***}”, pallati {***}, Tiranë, njësinë e shërbimit me sipërfaqe 117 m², të blerë në datën 30.12.2016, me vlerë 29.000 euro, si dhe pasi ka kryer analizën financiare për periudhën e rivlerësimit. Në vijim, të përmbledhura, shkaqet e ankimit për themelin e konkluzioneve dhe vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit.

C/I. Pasuria apartament në Tiranë

16. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të vlerës së kësaj pasurie në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2004, ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për sa i përket *burimit* të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *vetting* dhe ka *mungesë të burimeve të ligjshme* për këtë pasuri, në shumën prej (-) 2.803.690 lekësh.

16.1. Subjekti i rivlerësimit në ankim parashtron se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar. Subjekti ka deklaruar saktë në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2004 *sipërfaqen* e pasurisë prej 126 m², dhe që çmimi i blerjes që fillimisht ka qenë 33.000 euro, pas punimeve shtesë të kryera u shtua në 36.425 euro [e konvertuar në lekë 4.462.000 lekë]. Subjekti kërkon që kontrata e sipërmarrjes të mos konsiderohet si akt zyrtar. Me *moment prenontimi*, si kohë të pagesës, ka konsideruar vitin financiar të deklaramit të pasurisë [2004] dhe jo një datë konkrete. Kësti i fundit u pagua me përfundimin e pallatit. Për sa i përket *burimit* të krijimit, kësti i parë i paguar në muajin prill 2004, në vlerën prej 26.200 USD, përbëhej nga kursimet e vitit 2003 që kishin në banesë, ndërsa vlera prej 33.000 eurosh e mbetur është shlyer në dhjetor 2004, nëpërmjet huas nga E. B.. Në seancën publike në Kolegji, subjekti i rivlerësimit i qëndroi të gjitha parashtrimeve në ankim dhe argumentoi të njëjtat shkaqe.

16.2. Pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim dhe parashtrimet në seancë gjyqësore publike, si dhe aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurisë, bazuar në sipërfaqen dhe çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes. Për pasojë, pretendimet e subjektit në këtë drejtim u gjetën të pabazuara. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit shtjellohet në detaj në vijim.

16.3. Së pari, nga aktet në fashikull rezulton e dokumentuar sa vijon:

- a. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratën e porosisë, datë 18.03.2004 dhe blerjen e apartamentit me vlerë 4.562.000 lekë, më datë 12.04.2006²¹. Përpos adresës përkatëse të apartamentit është deklaruar edhe sipërfaqja prej 117,5 m².

²⁰ Sipas nenit 59, pikat 1 dhe 2: “[...] 1. Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme: a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; b) kur arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; c) kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. 2. Parashikimi i paragrafit të mësipërm nuk zbatohet për rastin e parashikuar në nenin 61, pika 5, të këtij ligji [...]”.

²¹ Kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.04.2006.

Burim krijimi janë deklaruar kursimet nga pagat e bashkëshortëve ndër vite, përkatësisht në vitet 1995 – 2004 (subjekti i rivlerësimit) dhe në vitet 1983 – 2004 (bashkëshorti), si dhe nga huaja prej 15.000 eurosh, pa kontratë nga një individ [E. B.].

- b. Në deklaratën e interesave periodike/vjetore 2004, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri me sipërfaqe 126 m², me vlerë 33.000 euro dhe specifikuar si ndërtuese shoqërinë “{***}” ShPK. Në seksionin e detyrimeve, subjekti nuk ka deklaruar asgjë. Personi i lidhur, bashkëshorti, në rubrikën e detyrimeve, në deklaratën e interesave periodike/vjetore 2004, ka deklaruar shtëpinë me sipërfaqe 127 m² dhe në seksionin e detyrimeve, një hua prej 15.000 eurosh të marrë në tetor 2004, për tre vjet, pa interes, nga E. B. dhe 3.000 euro të marrë hua në nëntor 2004, për një vit, pa interes, nga një individ [K. D.].
- c. Në deklaratën e interesave periodike/vjetore 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtimin e vlerës së këtij apartamenti me shumën prej 3.600 eurosh, ndërsa në deklaratën e interesave periodike/vjetore 2006, personi i lidhur [bashkëshorti] ka deklaruar vlerën përfundimtare të këtij apartamenti prej 36.425 eurosh dhe që shtëpia është hipotekuar në vitin 2006.
- d. Nga kontrata e sipërmarrjes, datë 18.03.2004, lidhur ndërmjet bashkëshortit dhe shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, rezultojnë shënime dhe fshirje të *sipërfaqes* së apartamentit [nga 71 m² në 126 m²] dhe *vlerës* së tij [është fshirë shifra 37.000 euro, por lënë e shkruar më fjalë e njëjta vlerë dhe vendosur shënimi se *20.000 euro do të paguheshin në datën 25.04.2004*].
- e. Sipas kontratës së shitblerjes, datë 12.04.2006, çmimi përfundimtar prej 4.462.000 lekësh ishte likuiduar jashtë zyrës noteriale.

16.4. Përpos dokumenteve zyrtare të sipërcituara, gjatë procesit të rivlerësimit dhe në ankim, në faza të ndryshme të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë dhënë një përshkrim të ndryshëm të disa aspekteve faktike. Këto mospërputhje janë më të dukshme për sa i përket kalendarit të pagesave.

16.4.i. Konkretisht, në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, datë 16.03.2019, subjekti ka deklaruar se apartamenti në fjalë, me sipërfaqe 126 m², (sipërfaqe e shfrytëzueshme 117.5 m²), është prenotuar në vlerën 33.000 euro, *shumë e cila është likuiduar dhe deklaruar në deklarimin e vitit 2004*. Vlera e apartamentit të blerë, sipas kontratës së shitjes, pas kryerjes së disa punimeve shtesë nga firma sipas kërkesës së blerësve, siç ka shpjeguar subjekti, është 36.425 (tridhjetë e gjashtëmijë e katërqind e njëzet e pesë) euro ose 4.462.000 (katër milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë.

16.4.ii. Në të njëjtin pyetësor, subjekti ka theksuar se në vitin 2004 nuk ka pasur *asnjë* detyrim ndaj firmës ndërtuese, pasi vlera e shtuar [sipas subjektit 3.425 euro] i përkiste disa punimeve shtesë të kërkuara nga ana e blerësve *në vitin 2005*, por të pa parashikuara në fillim nga firma ndërtuese. Burimi i krijimit të këtyre pagesave ka qenë gjendja *cash* prej 26.200 USD e deklaruar në DVP-në 2003 [e deklaruar e krijuar nga kursimet ndër vite nga të ardhurat nga pagat], si edhe një pjesë e huas prej 15.000 eurosh, marrë nga E. B..

16.5. Në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, datë 08.05.2019, subjekti ka shpjeguar se pagesat janë kryer pranë zyrave të shoqërisë “{***}” ShPK. Ndër to, 33.000 euro janë paguar *që në momentin e prenotimit* dhe më pas pjesa tjetër e pagesës prej 3.425 eurosh. Ky fakt provohet nga deklarata periodike vjetore përkatëse, ka theksuar subjekti. Subjekti ka kërkuar që Komisioni të bazohet në deklarimin periodik vjetor të kryer prej saj në vitet 2004 dhe 2005, pasi nuk disponon mandatpagesa të lëshuara nga shoqëria “{***}” ShPK dhe nuk ka kontakte me

përfaqësuesit e kësaj shoqërie. Kontrata në fjalë, që përbën *momentin e prenotimit*, mban datën 18 mars 2004.

16.6. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, sikurse edhe në ankim, subjekti ka shpjeguar një situatë të ndryshme faktike, e konkretisht:

i) Ka kryer deklaram shumë të saktë në deklaratat periodike, për sa i përket sipërfaqes dhe vlerës së pasurisë, ndërsa korrigjimet në kontratën e sipërmarrjes i atribuohen faktit që kontrata e sipërmarrjes ishte “kontratë tip”; me *moment të prenotimit*, kur është kryer pagesa prej 33 mijë eurosh, ka pasur parasysh *vitin financiar të deklaramit të pasurisë dhe jo një datë konkrete*.

ii) Kontrata e sipërmarrjes, datë 18.03.2004, parashikonte dorëzimin e apartamentit të përfunduar në dhjetor 2004, që nënkupton edhe likuidimin e plotë të vlerës së tij, me përfundimin e pallatit. Kështu, kësti i parë nuk është paguar në momentin e lidhjes së kontratës, por në prill 2004, me kursimet e deklaruara në banesë prej 26.200 USD, ndërsa pjesa e mbetur është paguar në dhjetor 2004 me huan e marrë nga E. B.; pagesat e këstit të parë kanë për burim *cash-in* e krijuar nga kursimet e vitit 2003, në vlerën prej 26.200 USD, që kishin në banesë. Në muajin dhjetor 2004, nëpërmjet huas nga E. B., kanë kryer pagesën e vlerës në total prej 33.000 eurosh.

16.7. Në mbështetje të deklarameve të saj, së bashku me përgjigjet mbi rezultatet e hetimit, subjekti ka depozituar në Komision një deklaratë të thjeshtë të hartuar gjatë procesit të rivlerësimit²², nga përfaqësuesi i shoqërisë “{***}” ShPK. Në këtë akt, referohet se kontrata e sipërmarrjes, lidhur mes kompanisë dhe personit të lidhur me subjektin në datën 18.03.2004, ka qenë e punuar mbi një kontratë tip, dhe se detajet e apartamentit të porositur janë shënuar me shkrim dore pas korrigjimit të të dhënave të mëparshme. Sipas këtij akti, çmimi fillestar i rënë dakord mes palëve ka qenë 33.000 euro dhe është paguar në dy këste, përkatësisht, një muaj pas lidhjes së kontratës së sipërmarrjes dhe në dhjetor 2004. Subjekti ka depozituar, gjithashtu, disa kopje kontratash shitjeje, lidhur midis disa individëve dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për shitblerje të apartamenteve në të njëjtën ndërtesë me atë ku gjendet apartamenti i blerë nga subjekti, nga të cilat rezulton se çmimi i shitjes për metër katror ka qenë i përafërt.

16.8. Trupi gjykues i Kolegjit, vëren paraprakisht se pretendimet e ngritura në një fazë të dytë të procesit e që bien ndesh me sa është argumentuar e shpjeguar nën përgjegjësi me herët për pagesë të ndarë në pjesë gjatë vitit 2004, janë jo bindëse. Këto pretendime të dyta paraqiten si përpjekje për të përmirësuar situatën sipas nevojës në proces. Nga ana tjetër, shpjegimet që u konstatuan të përkohjnë edhe me deklaramat periodike vjetore që përbëjnë dokument të hartuar nën përgjegjësi²³, nën dritën e nenit 49, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, u vlerësuan të besueshme dhe në harmoni me provat e tjera²⁴. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mbajti në konsideratë së pari, që pretendimi i subjektit se me *moment të prenotimit* ka dashur të nënkuptojë një hark kohor 9-mujor – mars deri në dhjetor – është i papranueshëm, qoftë nga interpretimi i thjeshtë logjik apo gramatikor. Së dyti, varianti i dytë i pagesave është jo bindës duke marrë në konsideratë kohën kur u paraqit për herë të parë – me kalimin e barrës së provës me rezultatet e hetimit administrativ – që do të thotë një moment të avancuar në procesin e rivlerësimit, pasi subjekti kishte dhënë shpjegime relativisht konsistente për faktin që janë kryer dy këste, nuk ka pasur detyrime të prapambetura dhe vlera në total ishte shlyer.

16.9. Në kushtet kur nga kontrata e shitblerjes, datë 12.04.2006, konfirmohet kalendari i pagesave, sipas kontratës së sipërmarrjes dhe nuk referohen të dhëna të ndryshme lidhur me

²² Lëshuar më datë 13.10.2019, nga S. Sh..

²³ Sipas ligjit nr. 9049/2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

²⁴ Neni 49, pika 4: “[...] Komisioni dhe Kolegji i Apelimt e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

momentin e kryerjes së pagesës(ave) përkatëse dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumente justifikuese momentin e kryerjes së pagesës(ave), trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të vërtetojë se pagesa e shumës prej 33.000 eurosh nuk është kryer në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, në datën 18.03.2004.

16.10. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se deklarata e thjeshtë e përfaqësuesit të kompanisë së ndërtimit “{***}” ShPK, [referuar në paragrafin 16.6 dhe poshtëshënimin përkatës], e datës 13.10.2019, paraqitur nga subjekti, nuk është bindëse. Sipas kësaj deklarate të panoterizuar, individ i referuar si deklarues pretendon se pagesat në funksion të kontratës së sipërmarrjes janë kryer në dy këste, prej të cilave kësti i parë [20.000 euro] rreth një muaj pas prenotimit dhe kësti i dytë në dhjetor 2004. Kjo deklaratë, e hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, ka vlerë të kufizuar provuese në kushtet kur në një qasje retroaktive tenton të ndryshojë faktet e deklaruara ndër vite dhe paraqitur një tablo të cilën palët nuk duket ta kenë pasqyruar në kontratën e shitjes. Së dyti, kjo deklaratë, e pambështetur në asnjë dokumentacion dhe e kryer në rrethana në të cilat është e pamundur të provohet identiteti i deklaruesit, mbetet deklarative dhe pa asnjë vlerë provuese në këtë kontekst.

16.11. Pavarësisht, dhe përpos këtij vlerësimi, edhe duke ndjekur një qasje shumë garantiste, në Kolegj u krye analiza financiare që do të rezultonte si pasojë e të dy alternativave të kalendarit të pagesave të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, e konkretisht: sipas kontratës së sipërmarrjes lexuar në harmoni me deklaratat periodike vjetore dhe pyetësorët, përkundër asaj sipas pretendimeve në ankim [dhe në përgjigje të barrës së provës]. Në të dy këto variante, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh për të krijuar pasurinë, për shkak të pamundësisë për të krijuar kursimet në *cash*, jashtë sistemit bankar në vlerën 26.200 USD, që janë pretenduar të kenë qenë në gjendje në 31 dhjetor 2003. Po ashtu, nga analiza e akteve në fashikull rezultoi se personi tjetër i lidhur E. B. ishte në pamundësi financiare për të dhënë huan prej 15 mijë eurosh. Të dy këto aspekte shtjellohen më poshtë.

16.12. Trupi gjykues i Kolegjit ia nënshtroi pretendimet e subjektit të rivlerësimit një analize financiare bazuar edhe në aktet në fashikull, për të kontrolluar mundësinë e kursimit të gjendjes *cash* prej 26.200 USD, për periudhën 1992 - 2003, të deklaruar si burim krijimi i apartamentit objekt analize në këtë rubrikë. Në analizën e kryer në Kolegj, rezulton një balancë negative për të krijuar kursimet në vlerën prej 696.708 lekësh²⁵. Si rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi të krijojnë vlerën *cash* të pretenduar në fund të vitit 2003. Në analizën e kryer në Kolegj, duke korrigjuar disa zëra të cilët rezultojnë qartazi të pasqyruar në akte e të cilët mungojnë në shpenzimet e përlllogaritura nga Komisioni, duke favorizuar situatën financiare të subjektit, kjo balancë negative thellohet. Ndër to, trupi gjykues gjeti se është e paqartë përse në shpenzimet e personit të lidhur, Komisioni nuk ka përfshirë edhe: (i) shpenzimet e kryera prej tij për blerjen e një apartamenti në Kukës në vitin 1994, në vlerën 1.3 milionë lekë²⁶ dhe shitur në vitin 2003, në vlerën 200 mijë lekë, me pjesë takuese ¼; (ii) shpenzimet jetike për periudhën 1983 e në vijim, ndonëse të ardhurat e personit të lidhur, përfshirë edhe ato të vitit 1983 e më pas, janë përlllogaritur sipas dokumentacionit, ndryshe nga sa referohet në analizën e Komisionit²⁷, sikurse janë përfshirë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit duke filluar nga viti 1993; (iii)

²⁵ Kjo është vlera që rezulton pas korrigjimit të analizës së kryer nga Komisioni për vitin 2003, konkretisht në zërin e të ardhurave të subjektit me vlerën 34.412 lekë, duke rezultuar në pakësimin e rezultatit negativ për këtë vit nga 731.120 lekë në 696.708 lekë. Në analizën e kryer në Kolegj, balanca negative e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar kursimet e deklaruara, rezulton më e thellë, minimalisht në vlerën 1.975.058 lekë.

²⁶ Bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 15.10.2018, të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës. Banesa nr. {***}, shk. {***}, pll. {***}, lagjja nr. {***}, Kukës

²⁷ Shih faqen 19-20 të rezultateve të hetimit administrativ të përcjella nga Komisioni subjektit të rivlerësimit, sipas së cilave, të ardhurat e personit të lidhur referohet se i përkasin vitit 1995 e pas. Nga verifikimi me dokumentacionin në fashikuj, rezulton se në fakt, Komisioni i ka përfshirë të ardhurat e bashkëshortit të subjektit për vitin 1992-1994.

shpenzime mobilimi në vlerën 250 mijë lekë, të kryera në momentin e lidhjes së martesës, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit²⁸. Në këtë analizë, ashtu si edhe në Komision, u përlloraritën shpenzimet për pagesën e 50% të pjesës takuese për njësinë në rrugën “{***}”, në Tiranë, kryer nga personi i lidhur në nëntor 2003, e cila analizohet veçmas në detaj në këtë vendim, numërtuar si pasuria II.

16.13. Në përmbledhje të sa më sipër, dhe pavarësisht nga përlloraritja e kryer në Komision, që ka anashkaluar zëra shpenzimesh të konsiderueshme të subjektit dhe personit të lidhur, ndërsa njëkohësisht ka përlloraritur të ardhurat e tyre ndër vite, në konsideratë të mospërkeqësimit të situatës procedurale pas ankimit, subjekti rezultoi të jetë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, për të krijuar kursimet prej 26.200 USD në fund të vitit 2003 në vlerën (-) 696.708 lekësh, për të paguar 33.000 euro në datën 18.03.2004. Në kushtet kur huaja nga E. B., pretenduar si një ndër burimet e pagesës së vlerës prej 33 mijë eurove, është marrë në tetor 2004²⁹, ndërsa pagesa është kryer në mars 2004, ajo nuk mund të përbëjë burimin e krijimit të pasurisë, në variantin e fakteve që rezultojnë nga dokumentet, mbi të cilët u bazua vlerësimi i kryer nga Kolegji.

16.14. Nga ana tjetër edhe analiza alternative e kryer nga Kolegji, në konsideratë të pretendimeve të subjektit në ankim, sipas kalendarit të pagesave në variantin e paraqitur rishtazi nga subjekti i rivlerësimit, tregoi që E. B. e kishte të pamundur të jepte huan prej 15 mijë eurosh në tetor 2004, pasi aktet e administruara në fashikull tregojnë se ai rezulton me mungesë burimesh të ligjshme. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës për këtë aspekt.

16.14.i. Siç specifikohet më sipër në paragrafët 16.3/a dhe 16.3/b, huaja prej 15.000 eurosh është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe nga personi i lidhur [bashkëshorti] në deklaratën periodike/vjetore 2004, duke identifikuar huadhënësin [E. B.], momentin e marrjes [tetor 2004], sikurse edhe një hua tjetër, në vlerën 3.000 euro, marrë në nëntor 2004 [nga K. D.]. Në deklaratat periodike/vjetore 2005-2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përkatësisht shlyerjen e shumave prej 3.000 eurosh dhe 15.000 eurosh, pa identifikuar huadhënësit.

16.14.ii. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një dokument të datës 12.03.2019³⁰, sipas së cilit vërtetohej se E. B. kishte tërhequr nga shoqëria “{***}” shumën prej 1.785.000 lekësh, në vitin 1997, ekuivalenti i 14.166 eurosh. Nga ky akt, rezulton se E. B. është shpallur debitor me vendimin nr. {***}, datë 31.08.1999, të shoqërisë “{***}”, në administrim. Po ashtu, në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka paraqitur në Komision edhe shtatë (7) akte të tjera³¹, në mbështetje të pretendimeve të saj për mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, për t’i huazuar bashkëshortëve Muçmataj 15 mijë euro.

²⁸ Pyetësori nr. {***}, datë 08.05.2019, pyetja 4.

²⁹ Deklaruar në deklaratën *vetting* dhe shoqëruar me deklaratën noteriale, datë 23.04.2016, të M. B. [nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.04.2016], bashkëshorte e huadhënësit, E. B.. Sipas deklaruësës, bashkëshorti i saj, (i cili ndodhej në ShBA) në momentin e deklarimit, i ka dhënë hua personit të lidhur me subjektin I. M., 15.000 euro pa interes, në vitin 2004.

³⁰ Vërtetimi nr. {***}, datë 12.03.2019, i shoqërisë huamarrëse “{***}”, në administrim, ka tërhequr nga kjo shoqëri në vitin 1997, shumën prej 1.785.000 lekësh, e cila e konvertuar në euro është e barabartë me 14.166 euro.

³¹ Me prapësimet mbi rezultatet e hetimit të Komisionit, subjekti ka paraqitur edhe aktet si vijon: (i) pesë vërtetime nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës, të lëshuar përkatësisht në datat 15.10.2019 dhe 18.10.2019, të cilët konfirmojnë punësimin e M. B. në institucione të ndryshme në periudhat kohore të ndryshme [1985 – 1996 dhe 2008 – 2014], ndërsa E. B. ka qenë i punësuar në periudhën kohore 1985 – 1988 dhe që M. dhe E. B. kanë derdhur rregullisht kontributet për sigurime shoqërore për periudhën 1993-2007, si të vetëpunësuar në bujqësi. Vërtetimi për M. B., për punësimet në detyrën e punëtores, operatores dhe më pas juristes, nuk specifikon pagat; (ii) deklaratë noteriale [nr. {***} rep., nr. {***} kol., date 12.10.2019], sipas së cilës deklaruesit I. E. dhe M. B. deklarojnë, ndër të tjera, se në vitin 2000 I. E. ka paguar vlerën prej 1.400.000 lekësh për blerjen e dy apartamenteve në pronësi të E. e M. B., në cash, ndonëse kontratat e janë nënshkruar në vitin 2007 [shtatë vjet më pas] dhe që çmimi në kontrata nuk përkon me realitetin, për të evituar tatimin mbi fitimin që shitësi duhet t’ia

16.14.iii. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi i analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet në fashikull, vlerëson që pretendimet e subjektit mbetën të paprovuara. Në tërësinë e tyre, aktet e sipër referuara, sjellë nga subjekti në cilësinë e provës, dështuan të provojnë mundësinë financiare të E. B. dhe bashkëshortes së tij, për të pasur vlerën e deklaruar të dhënë hua në momentin e pretenduar.

16.14.iv. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit mbërrin pasi vëren se shuma e përfituar nga personi tjetër i lidhur E. B., nga shoqëria “{***}”, i përkiste periudhës kohore të vitit 1997. Në kushtet kur huaja pretendohet të jetë dhënë në fund të vitit 2004, shtatë (7) vjet më pas, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se huadhënësi e kishte në posedim këtë shumë në momentin e dhënies së huas, në kuptim të pikës 18 e 19 të udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së³² (në vijim “Udhëzimi nr. 4095/2016”). Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në kushtet kur E. B. është shpallur debitor në vitin 1999 për shumën e tërhequr, ligjshmëria e burimit të huas, nën dritën e nenit D, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vihet në pikëpyetje që në zanafillën e investimit dhe tërheqjes së saj, edhe nëse abstragohet nga harku kohor disavjeçar që ka kaluar deri në momentin e dhënies së huas.

16.14.v. Më tej, nga analiza e akteve në fashikull, për sa i përket të ardhurave të çiftit B. nga punësimet [cituar e përmbledhur në poshtëshënimin nr. 31], nuk rezulton që E. B. dhe bashkëshortja e tij të ketë gjeneruar mjaftueshëm të ardhura sa të provojë burimin e ligjshëm në momentin e dhënies së huas.

16.14.vi. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se sa pretendohet të provohet për përfitimin e shumës prej 1.4 milionë lekësh nga shitja e një apartamenti në Kukës nga huadhënësi, nëpërmjet dy akteve³³ – deklarata noteriale e vitit 2019 e lëshuar bashkërisht nga një blerës dhe bashkëshortja e huadhënësit në cilësinë e shitësit të apartamentit – dhe shkresa e lëshuar nga Ujësajllësi Kukës – janë pa vlerë provuese. Kjo deklaratë noteriale e lëshuar gjatë procesit të rivlerësimit, pikë së pari, bie ndesh me kontratën e shitjes, e cila dokumenton shitjen e një apartamenti në datën 03.12.2007³⁴, në vlerën 800.000 lekë. Në këtë kontratë, E. B. dhe M. B., në cilësinë e shitësve, kanë nënshkruar fitimin e vlerës në fjalë në vitin 2007. Nga ana tjetër, deklarata noteriale e vitit 2019 kërkon të pranohet një pretendim deklarativ që synon të provojë fakte që bien ndesh me një kontratë të rregullt të lidhur mes palëve. Deklaruesit përpiqen të provojnë që pagesa e apartamentit është kryer jo vetëm disa vite përpara veprimtari juridik të shitjes, por edhe për një vlerë shumë më të lartë sesa ajo e dokumentuar në kontratë. Deklarata noteriale e blerësit dhe shitësit përpiqet të provojë një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që pranohet se çmimi i kontratës është fiktiv, për të lejuar E. B. të paguante tatim më të ulët mbi fitimin, dhe që pagesa faktikisht ka ndodhur shtatë vjet më herët sesa kontrata. Ky pretendim nëpërmjet deklaratës noteriale paraqet probleme besueshmërie në disa nivele. Së pari, sepse kontrata e lidhur rregullisht mes palëve ka forcën e ligjit, sipas nenit 690 të Kodit Civil. Deklarata noteriale e hartuar 12 vjet më pas, e që referon një vlerë transaksioni gati dyfish më të lartë dhe të kryer shtatë vjet përpara se të dokumentohej sipas ligjit, nuk mund të zhbëjë vlerën provuese të kontratës së shitjes. Së dyti, pretendohet një fakt gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit që qartazi duket se ka qëllim të përshkruajë veprimet juridike në një

*paguante buxhetit të shtetit; (iii) vërtetim datë 11.10.2019 nga Ujësajllësi Kanalizime Kukës, sipas së cilit apartamenti me adresë lagjja {***}, pll. {***}, shk. {***}, deri në shkurt të vitit 2000, ka pasur të jetë faturuar abonentin E. B. dhe nga shkurti 2000 e në vazhdim, rezulton i faturuar abonenti I. E..*

³² “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

³³ Përmbledhur në poshtëshënimin nr. 30, germa “ii” dhe “iii”.

³⁴ Kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.12.2007.

dritë favorizuese për subjektin e rivlerësimit. Së fundmi, pretendohet të provohen të ardhura të përfituara në kushtet e evazionit fiskal, që automatikisht passjell paligjshmërinë e burimeve të krijimit të të ardhurave nga huadhënësi E. B., nën dritën e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, edhe nëse sasia dhe ekzistenca e tyre do të ishte e pakontestuar/shme.

16.14.vii. Për pasojë, nga analiza e shtjelluar më sipër, trupit gjykues të Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm duke mos e justifikuar me të ardhura të mjaftueshme huan prej 15.000 eurosh, në vitin 2004. Të ardhurat e dokumentuara për çiftin B. nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar dhënien e huas prej 15.000 eurosh, në tetor 2004.

16.15. Në përmbledhje të gjithë sa më sipër, lidhur me pasurinë apartament banimi [me sip. 117,5 m², në rrugën “{***}”, pallati {***}, Tiranë], trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion u bazua mbi përlllogaritjen e vlerës së apartamentit të referuar në kontratën e shitjes dhe duke çmuar se pagesa është kryer në një hark kohor që përkon me momentin e prenotimit, siç është deklaruar prej vetë subjektit, ndërsa konstatoi se huaja e pretenduar në deklaratën e pasurisë *vetting* si burim është marrë shtatë (7) muaj pas lidhjes së kontratës së sipërmarrjes. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, që përpiqen ta përshkruajnë pagesën përgjatë gjithë vitit, u çmuan nga trupi gjykues i Kolegjit se nuk përputhen me sa është përshkruar në kontratën e shitjes dhe atë të sipërmarrjes dhe dokumentet e tjera të administruara në fashikull gjatë procesit dhe gjykimit në Kolegj për këtë pasuri.

*C/II. Njësi shërbimi/lokal në rrugën “{***}”³⁵*

17. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit në mënyrë të pasaktë nuk ka deklaruar në deklaratën fillestare 2003 dhe deklaratën periodike/vjetore 2005 të drejtat reale mbi këtë pasuri, interesat e posaçme pasurore me shoqërinë “{***}” ShPK dhe raportet me N. D., ka bërë deklaram të pasaktë të sipërfaqes dhe vlerës së kësaj pasurie në deklaratën *vetting* dhe deklaratën periodike/vjetore 2006, ka bërë deklaram të rremë në deklaratën *vetting* lidhur me kredinë nga “{***}”, si burim i krijimit të pasurisë, si dhe nuk justifikonte me burime financiare të ligjshme vlerën prej 15.000 eurosh [gjysmën e çmimit] të paguar, sipas kontratës së datës 05.11.2003. Sipas analizës financiare të kryer në Komision, ky vit rezulton me një diferencë negative në vlerën prej (-) 731.120 lekësh. Së fundmi, Komisioni ka konkluduar se subjekti në mënyrë të pasaktë nuk ka deklaruar në deklaratën periodike/vjetore 2006 huan nga Sh. B..

17.1. Në parashtrimet në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit duke argumentuar, ndër të tjera, se: Nuk ka pasaktësi në deklarimin e viteve 2003 dhe 2004, pasi në ato vite nuk ka pasur asnjë të drejtë reale mbi këtë pasuri, për sa kohë nuk kishte paguar asgjë për krijimin e saj; pjesa e saj takuese është deklaruar në deklaratën e interesave periodikë/vjetor 2006, ndërsa sipërfaqja në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit ka qenë gabim material. Lidhur me marrjen dhe shlyerjen në vitin 2006 të huas prej 3.000.000 lekësh nga Sh. B., pretendon se ligji nuk e ngarkonte me detyrimin për të deklaruar një marrëdhënie që kishte lindur dhe ishte mbyllur brenda të njëjtit vit kalendarik, e cila nuk kishte ndikuar në shtesa dhe pakësim të pasurisë. Pagesa e këstit të parë, për këtë pasuri në vitin 2003, është kryer nga bashkëpronari N. D., ndërsa pjesën e saj takuese e ka shlyer në vitin 2006.

17.2. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti referon dy deklarata noteriale të lëshuara nga një individ që ka pasur cilësinë e bashkëpronarit për këtë pasuri [N. D.], paraqitur

³⁵ Sipas kartelës së pasurisë, me sipërfaqe 117,5 m². Njësia ndodhet në rrugën “{***}”, pallati “{***}” ShPK.

respektivisht, pasi subjekti mori rezultatet e hetimit administrativ dhe në seancën gjyqësore në Komision, një shkresë të shoqërisë “{***}” ShPK, datë 17.06.2019, të paraqitur pas rezultateve të hetimit, deklaratën periodike vjetore për vitin 2006, të hartuar prej saj si subjekt deklarues i ligjit nr. 9049/2003, si dhe një deklaratë të thjeshtë nga administratori i shoqërisë ndërtuese të kësaj pasurie “{***}” SHPK, po ashtu paraqitur pasi subjekti është njohur me rezultatet paraprake të hetimit³⁶. Subjekti i rivlerësimit kontestoi përcaktimet në një kopje të kontratës së sipërmarrjes së depozituar në ZVRPP, në të cilën palë porositëse paraqitet vetëm personi i lidhur.

17.3. Në parashtrimet me shkrim përcjellë Kolegjit në datën 09.06.2022, përmbledhur ndër të tjera në paragrafin 7.2 më sipër, subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe 5 (pesë) akte të reja në cilësinë e provës³⁷, të cilat ka pretenduar se ka qenë në pamundësi t’i paraqiste gjatë procesit në Komision dhe në ankim, që provojnë që pagesa e parë e kryer nga personi i lidhur, për këtë pasuri, ka ndodhur vetëm në vitin 2006. Pagesat prej 30 mijë eurosh në tetor dhe nëntor 2003 janë kryer nga [tashmë, i ndjeri] N. D.. Në parashtrimet në seancën gjyqësore publike në Kolegj, subjekti kërkoi rikryerjen e analizës financiare për mundësinë e blerjes së ½ së pasurisë prej personit të lidhur, duke marrë në konsideratë sa rezulton nga mandatpagesat e reja. Po ashtu, subjekti kërkoi që deklaratat noteriale të lëshuara nga N. D., meqenëse ai ka ndërruar jetë, të marrin vlerë provuese më të spikatur për këtë shkak. Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë në asnjë formë dhe nuk u ka dhënë asnjë peshë këtyre deklaratave, theksoi subjekti.

17.4. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, aktet e reja të sjella prej saj në cilësinë e provës, si dhe kreu një analizë financiare bazuar në të dhëna me të cilat subjekti është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se vendimi i Komisionit për këtë pasuri është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar këtë pasuri dhe ka kryer deklaram të rremë për burimin e krijimit të saj. Ky konkluzion u mbështet në arsyetimin e shtjelluar në vijim.

17.5. Së pari, nga aktet rezulton e dokumentuar sa vijon:

- a. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar porositjen sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 05.11.2003 dhe blerjen e kësaj pasurie, nëpërmjet kontratës së shitjes së datës 30.12.2016, me vlerë 29.000 euro. Prona deklarohet në bashkëpronësi me N. D. dhe ka për burim kredinë nga “{***}”, në vitin 2006 dhe një dhurim nga i ati i bashkëshortit [I. M.] në datën 31.12.2005. Dhuruesi [vjehri] ka përfituar shpërblim për shkak të shpronësimit si pasojë e ndërtimit të aeroportit të Kukësit.
- b. Në deklaratën fillestare të pasurisë [2003] plotësuar në datën 28.03.2004 dhe në deklaratën periodike/vjetore 2004, subjekti i rivlerësimit *nuk e ka deklaruar* porositjen e kësaj pasurie.
- c. Në deklaratën periodike për vitin 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në seksionin e interesave private të personave të lidhur: *Lokal pa certifikatë pronësie me kontratë porosie, në emër të I. M..*
- ç. Për herë të parë, subjekti ka deklaruar detaje të pasurisë në deklaratën periodike vjetore për vitin 2006. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë deklaruar

³⁶ Përkatësisht, deklaratat e N. D. mbajnë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.03.2019 dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.10.2019. Deklarata noteriale e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK mban datën 12.10.2019.

³⁷ Cituar e përmbledhur në poshtëshënimin nr. 6.

porositjen e lokalit me sipërfaqe 158 m², pjesë takuese nga 25% secili bashkëshort, në vlerën 58 mijë euro, në bashkëpronësi [me N. D.].

- d. Sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 05.11.2003, kompania “{***}” ShPK, investitori dhe porositësit [I. M. dhe N. D.] kanë rënë dakord për ndërtimin e një lokali me sipërfaqe 170 m², me adresë të referuar më sipër dhe çmim prej 59.500 eurosh.
- i) Kontrata parashikon për kohën dhe mënyrën e pagesave si vijon: kësti i parë prej 30.000 eurosh është paguar me nënshkrimin e kontratës; kësti i dytë do të paguhej *me mbarimin në tullë në katin që ndodhet dyqani (karabina)*; kësti i tretë *me dorëzimin e çelësave*.
 - ii) Sipas nenit 4, çmimi do të paguhej *jo më vonë se fundi i muajit mars të vitit 2004*.
 - iii) Në krah të nenit 2 të kontratës rezultojnë dorëshkrime të shtuara, që referojnë pagesa dhe numërtim mandatarkëtimesh, sipas së cilave citohet pagesa e dy shumave dhe totalit prej 30 mijë eurosh, deri në datën që mban kontrata [05.11.2003], përkatësisht më 27 tetor dhe 5 nëntor 2003³⁸.
 - iv) Në krah të nenit 3 të kontratës është shtuar një shënim, po ashtu me shkrim dore, sipas së cilit referohet se *pagoi sot më datë, 26.05.2004, shumën 20.000 (njëzet mijë) euro*.
- dh. Sipas kontratës së shitblerjes, datë 30.12.2016, pasuria “njësi” referohet me sipërfaqe 117 m², sipërfaqe të përbashkëta (ballkone anësore) 53 m², total 170 m² dhe çmimin 59.500 euro. Palët shprehen se e kanë likuiduar çmimin, *sipas kontratës së sipërmarrjes së sipërcituar*.
- e. Në datën 31.12.2005 është hartuar kontratë noteriale dhurimi në favor të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit [bashkëshortit], nga i ati, në vlerën 4 milionë lekë. Dhuruesi I. M. shprehet se shuma ka prejardhje nga kompensimi për shpronësimin nga buxheti i shtetit në favor të tij, në vlerën 6 milionë lekë, i përfituar për shkak të ndërtimit të aeroportit të Kukësit.
- ë. Në datën 18.07.2006, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, kanë lidhur kontratë kredie për 3 milionë lekë dhe 3 mijë euro me “{***}”, me afat të pacaktuar. Qëllimi i kredisë është i paspecifikuar. Shuma e lëvruar, sipas këtij transaksioni, rezulton e disbursuar nga banka në datën 18.08.2006, në vlerën prej 2.970.000 lekësh. Në të njëjtën ditë, personi i lidhur i ka transferuar vlerën e disbursuar të kredisë një personi tjetër, z. Sh. B., me përshkrimin *kalim nga I. M. për Sh. B. për shlyerje detyrimi, sipas kontratës së huamarrjes datë 07.06.2006*.
- f. Kredia është shlyer tërësisht në vitin 2010. Një pjesë e pagesës fundore, në vlerën 1.3 milionë lekë, është kryer nga N. D.. Sipas deklaratës noteriale të hartuar më 26.04.2016 nga N. D., ka vepruar për llogari të subjektit dhe personit të lidhur, të cilët ishin në pamundësi shëndetësore.

17.6. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në ankim e në parashtrimet në Kolegj, argumentojnë një situatë të ndryshme nga sa rezulton nga gjithë aktet e sipërcituara, si për mënyrën, ashtu edhe për kohën e shlyerjes së pagesës. Konkretisht, dokumenti i vetëm i kohës – kontrata e sipërmarrjes dhe shënimet me shkrim dore – dukshëm mbajtur për të ruajtur të dhëna në kohë reale, referon një situatë tipike bashkëpronësie. Asgjë nuk mbështet pretendimin e subjektit për shlyerje veçmas nga ndonjëri prej bashkëpronarëve apo detyrime të ndara në kohë, që do të përkonte me situatën faktike të kohës. Edhe shkresa e parë, dërguar Komisionit nga

³⁸ *Dorëshkrimet e shtuara lexojnë përkatësisht: “MA nr. {***}, datë 27/10 - 500.000 lekë = 3690 euro” dhe “MA nr. {***}, datë 5/11, 26.310 uro dhe 30.000 euro”.*

administratori i shoqërisë “{***}” ShPK³⁹, nuk prezanton një tablo faktike që të përkohet me pretendimet e mëvonshme të subjektit se detyrimet u shlyen veçmas dhe ndarë në kohë nga secili prej bashkëpronarëve. Administratori i referohet palëve kontraktore bashkërisht, si “porositësit” në atë shkresë të parë⁴⁰. Nga ana tjetër, z. B. parashtron një kalendar të ri pagesash⁴¹, që bie ndesh me të dy kontratat, sikurse edhe me shënimet në atë të sipërmarrjes.

17.7. Argumentet e parashtruara nga subjekti, në një fazë të avancuar të procesit të rivlerësimit, nuk janë pasqyruar as në deklaratat periodike vjetore apo në deklaratën e pasurisë. Në kushtet kur harku kohor i viteve 2003-2005 përkon me investime të konsiderueshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në dy pasuritë e paluajtshme objekt i këtij arsyesimi, ndërsa kredia bankare dhe dhurimi në favor të personit të lidhur nga i ati kanë ndodhur në fund të këtyre viteve, por dhe pas këtij harku kohor, versioni i ri i papretenduar më parë dhe i pambështetur as në kontratën e shitjes u gjet jobindës nga trupi gjykues. Ky konstatim gjen zbatim, qoftë për sa i përket pretendimit për veçori në shlyerjen e pagesave nga vetëm njëri prej bashkëpronarëve në këtë periudhë kohore, që bie ndesh me detyrimet e bashkëpronësisë sipas Kodit Civil, por edhe për sa i përket mënyrës së kryerjes së pagesës – në këste që nuk përkojnë me përcaktimet e shkruara me shtyp e dorëshkrim të pagesave, konfirmuar më pas me kontratën e shitblerjes.

17.8. Kjo situatë e mjegullt deklarimesh rezulton edhe nga analiza e shpjegimeve të subjektit, pasi është kërkuar të japë shpjegime në ILDKPKI në vitin 2016, lidhur me këtë pasuri. Konkretisht, në ato shpjegime, subjekti referon vetëm vitin 2005 – ndërkohë që kontrata është lidhur në gjysmën e parë të vitit 2003 – dhe pagesat e evidentuara deri në 50 mijë euro [84% të vlerës] ishin likuiduar në fund të majit 2004. Subjekti rezulton të ketë vendosur vitin 2005 si prag kohor të transaksioneve të pasurisë, që duket si përpjekje për të vendosur data që përkojnë me herën e parë kur është deklaruar për këtë pasuri. Konkretisht, në shpjegimet në ILDKPKI në vitin 2016, subjekti është shprehur se: [...] *Lokali që kam deklaruar në deklarin e këtij viti [2005] është lokali që është rideklaruar prej meje një vit më vonë në vitin 2006 [...]. Në këtë vit [2005] prej meje dhe bashkëshortit [I. M.] nuk është kryer asnjë pagesë, për arsye se investimi fillestar u krye nga çifti D. [N. D. dhe H. D.], të cilët sqaroj se janë kumbarët e djalit tim të vogël, pra, kemi lidhje familjare [...]*⁴².

17.9. Trupi gjykues, në përmbledhje dhe analizë të sa më sipër, kreu vlerësimin ligjor në Kolegj dhe analizën financiare, duke u bazuar në kontratën e shitjes, që nën dritën e normave që rregullojnë marrëdhëniet juridike civile ka forcën e ligjit për palët. Në këtë kontratë – përmbledhur më sipër në paragrafin 17.4, germa “F”, për palët daton dhjetor 2016 – konfirmohen pagesat në kohën e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, sipas së cilës, pagesat janë kryer tërësisht ose të paktën deri në vlerën që përbën 84% të çmimit [50 mijë euro] brenda muajit maj të vitit 2004. Mandatpagesat e sjella si provë e re në procesin publik gjyqësor në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar një kalendar të ndryshëm nga kontrata, u çmuan pa vlerë provuese nga trupi gjykues i Kolegjit, pasi rezultojnë se bien ndesh me gjithë dokumentet në

³⁹ Shoqëria “{***}” ShPK, me administrator R. B., në përgjigjen e kthyer Komisionit më datë 17.06.2019, ka specifikuar që në momentin e nënshkrimit të kontratës së porositësit kanë paguar 30.000 euro. Kësti i tretë në vlerën 29.500 euro, referohet të jetë paguar nga porositësit në vitin 2006.

⁴⁰ Në një deklaratë të thjeshtë të datës 12.10.2019, që daton pasi subjekti është njohur me rezultatet e hetimit administrativ në Komision, R. B., sërish në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, deklaroi në mënyrë të përgjithshme, të njëjtat gjëra si subjekti apo si N. D., për sa i përket pagesave të kryera, duke u fokusuar kryesisht në problematikat e mospërputhjes së sipërfaqes së pasurisë, si dhe vlefshmërinë e kontratës së sipërmarrjes që është pjesë e fashikullit të depozituar në ZVRPP, sipas së cilës personi lidhur me subjektin, bashkëshorti, shfaqet në cilësinë e porositësit të vetëm, pa z. D.. Kjo kopje e kontratës mban të njëjtën datë me atë të fashikullit të rivlerësimit, 05.11.2003.

⁴¹ Shih përgjigjen e z. B. Komisionit në datën 17.06.2019 referon shlyerjen e një shume prej 49% të vlerës vetëm në vitin 2006, ndërkohë që kontrata e sipërmarrjes nëpërmjet dorëshkrimeve konfirmon pagesën e 84% të çmimit total që në maj 2004.

⁴² Procesverbali, datë 20.04.2016, i ILDKPKI-së, mbi shpjegimet e subjektit deklarues, sipas ligjit nr. 9049/2003.

fashikull analizuar më sipër. Në kushtet kur palët kanë treguar vullnetin e tyre me akte shkresore ndër vite, çdo ndryshim i kushteve mund të rregullohej lehtësisht prej tyre në kohën kur ndodhnin veprimet.

17.10. Në konkluzion, për këtë shkak ankimi, nën dritën e dispozitave të Kodit Civil për vlerën provuese të kontratave të lidhura rregullisht dhe të nenit 49, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, që kërkon që vendimi të bazohet në prova të besueshme nga burime të njohura, kërkesa e subjektit të rivlerësimit për të bazuar vendimmarrjen mbi një mënyrë dhe kohë shlyerjeje të detyrimeve që nuk ka gjetur asnjë gjurmë në asnjë akt dokumentar të kohës dhe jo vetëm, u vlerësua nga Kolegji si një përpjekje për të pasqyruar faktet në një dritë favorizuese për subjektin në procesin e rivlerësimit. Për të njëjtat shkaqe, trupi gjykues i gjeti pa vlerë provuese deklaratat e hartuara nga N. D. dhe R. B., përkatësisht në datat 15.03.2019 dhe 12.10.2019, pasi ato bien ndesh me aktet me fuqi të plotë provuese të analizuar më sipër dhe përpiqen të provojnë fakte të ndryshme nga ato të cilat rezultojnë nga aktet e hartuara nga palët në formën e kërkuar nga ligji, në mënyrë retroaktive – përgjatë procesit të rivlerësimit – dhe janë jo konsekuente⁴³ e të pambështetura në asnjë dokument.

17.11. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit i gjen mandatarkëtimet e sjella nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit në Kolegj të pavlefshme edhe për nga forma, përpos jo bindëse për nga përmbajtja. Nga një analizë e përmbajtjes së tyre, rezulton se mandatpagesave u mungojnë elementët e formës, sipas ligjeve që rregullojnë kontabilitetin Konkretisht, mandatarkëtimeve u mungon edhe numri i serisë, janë nënshkruar nga financieri, por nuk janë nënshkruar nga depozituesit, përkatësisht N. D. apo I. M., mungon vula e shoqërisë lëshuese (e cila do të evidentonte formën juridike dhe adresën e shoqërisë) dhe njëri prej tyre nuk ka as emrin e shoqërisë lëshuese në krye [mandati nr. 30, datë 05.11.2003]⁴⁴. Burimi tjetër i deklaruar, për krijimin e pasurisë objekt i kësaj analize, është një pjesë e kredisë nga “{***}” dhe dhurimi nga babai i bashkëshortit. Pa përsëritur sa është referuar më sipër në detaj, nga aktet në fashikull [cituat në paragrafin 17.5/ë] rezulton se e gjithë shuma e kredisë së përfutur i është transferuar në të njëjtën ditë nga personi i lidhur [bashkëshorti i subjektit], një individ tjetër, Sh. B.. Transaksioni i kalimit në favor të Sh. B. referon një huamarrje të një muaji përpara kontratës së kredisë, më 7 qershor 2006. Si huaja e marrë nga Sh. B., ashtu edhe shlyerja e këtij detyrimi, nuk janë deklaruar në deklaratën periodike/vjetore 2006. Në përfundim të hetimit, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka kryer deklaram të rremë në lidhje me kredinë si burim krijimi të kësaj pasurie. Në këtë vlerësim, Komisioni ka mbërritur, pasi ka dëgjuar edhe shpjegimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, e cila ka pranuar që kredia në fakt nuk është përdorur për blerjen e pasurisë, ndryshe nga sa ajo ka deklaruar në deklaratën e pasurisë dhe atë periodike.

17.12. Në analizë të akteve në fashikull dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim dhe në seancën gjyqësore publike në Kolegj, trupi gjykues konstaton se ky konkluzion i Komisionit është i drejtë. Qartazi, aktet tregojnë që kredia nga “{***}” nuk ka shërbyer për krijimin e pasurisë objekt analize. Për pasojë, subjekti gjendet në kushtet e deklaramit të rremë.

⁴³ Ndryshe nga sa ka referuar në shkresën datë 17.06.2019, përmbledhur e cituar më sipër, në deklaratën e thjeshtë të hartuar në datën 12.10.2019, kërkuar prej I. M. [bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit], administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, R. B., paraqitur në Komision nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit, referon një bisedë me N. D. gjatë së cilës ka mësuar se pagesat do të bëheshin prej tij [z. D.] pasi I. M. “për momentin nuk kishte mundësi paguese, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre” dhe që “në momentin e dorëzimit të lokalit, pagesa prej 29.500 eurosh u krye nga I. M.”. Deklarata noteriale e hartuar nga N. D. gjatë procesit të rivlerësimit, referon një situatë faktike të njëjtë me atë të pretenduar nga subjekti për pamundësi shlyerje detyrimesh, sipas kontratës dhe për marrëveshje të bashkëpronarëve që bie ndesh me sa është parashikuar në kontratën e sipërmarrjes dhe atë të shitjes për kohën e shlyerjes së detyrimeve nga personi i lidhur me subjektin.

⁴⁴ Referuar “Sistemit kontabël të përgjithshëm”, miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë nën dritën e nenit 2 të ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993, “Për kontabilitetin”, dokumenti justifikues bazë – mandatarkëtimi – përgatitet në kohën kur kryhet veprimi dhe duhet të përmbajë të gjitha elementet e renditura në këtë pikë, përfshirë emrin, formën juridike dhe adresën e shoqërisë.

Pretendimet kontradiktore të subjektit në pyetësorë, përkundër në përgjigje të rezultateve të hetimit, që bien ndesh me deklaratën *vetting*, përpos që tregojnë disa variante të ndryshme, nuk janë bindëse, qoftë për shkak të mospërputhjeve, edhe sikurse nuk mbështeten nga asnjë provë apo gjurmë, qoftë edhe rrethanore. Konkretisht, ndërsa në pyetësorin nr. {***}⁴⁵ subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk i kujtohet roli i Sh. B. në kontekstin e kredisë së marrë prej saj e bashkëshortit për investim, në përgjigjet pas rezultateve të hetimit⁴⁶, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *kredia e marrë në “{***}” nuk është përdorur nga ana jonë për blerje të lokalit (njësi shërbimi). Për blerjen e lokalit është përdorur vlera prej 4.000.000 lekësh e dhuruar nga babai i bashkëshortit, sipas kontratës së datës 31.12.2005.*

17.13. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë përdorur shumën e përfituar nga kredia për të shlyer një pagesë, referuar si detyrim nga një hua tjetër, e padeklaruar. Së dyti, subjekti i rivlerësimit në asnjë fazë të procesit nuk arriti të provonte përdorimin e kredisë për qëllim të krijimit të pasurisë objekt analize. Për pasojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë për burimin e krijimit të kësaj pasurie.

17.14. Nën dritën e arsytimit të shtjelluar më sipër, për sa i përket kohës kur rezulton të jenë kryer transaksionet që kanë passjellë krijimin e kësaj pasurie, bazuar në dokumentacion, rezulton, po ashtu, që personi i lidhur me subjektin dhe bashkëpronari kanë dokumentuar krijimin e kësaj pasurie në vlerën 50 mijë euro, në harkun kohor mars 2003 deri në maj 2004 – sipas përcaktimeve në kontratën e shitjes, ndër të tjera, shpjeguar më sipër. Për rrjedhojë, pas analizës financiare të kryer në Kolegj, mbi bazën e të dhënave dhe analizës së përcjellë subjektit të rivlerësimit nga Komisioni me rezultatet e hetimit administrativ dhe në reflektim të shkaqeve të ankimit që u gjenden të bazuara, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Në analizën financiare të kryer në Kolegj u mor në konsideratë fakti që kontrata e dhurimit nga babai i personit të lidhur daton dhjetor 2005 e, për pasojë, mund të shërbente vetëm për pagesën e kryer në vitin 2006 – nëse pranohen këstet siç janë dokumentuar në kontratën e sipërmarrjes. Në konkluzion, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk justifikon me burime financiare të ligjshme vlerën prej 15.000 eurosh [gjysmën e çmimit] të paguar sipas kontratës së datës 05.11.2003, pasi viti 2003 rezulton me një diferencë negative në vlerën prej (-) 696.708 lekësh.

17.15. Në përmbledhje të sa më sipër, pasi analizoi në tërësi pretendimet e ngritura dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, parashtrimet dhe pretendimet në seancë publike lidhur me pasurinë lokal, me sipërfaqe 117 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie dhe ka kryer deklaram të rremë për burimin e krijimit, pasi kredia e marrë nga “{***}” provohet se nuk ka shërbyer për të krijuar këtë pasuri, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, geramat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.

C/III. Analiza financiare

- 18.** Nga analiza financiare e kryer në Komision për vitet 2003-2016, subjekti i rivlerësimit rezultoi me një balancë negative në vlerën totale prej (-) 6.417.174 lekësh. Analiza financiare, me të cilën subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës, nëpërmjet rezultateve të hetimit, kishte evidentuar një balancë negative prej (-) 4.796.614 lekësh⁴⁷. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b”, për të

⁴⁵ Përgjigjet e regjistruara me nr. {***} prot., datë 08.05.2019, në vijim të pyetësorit nr. {***}, f. 4.

⁴⁶ Prapësime pas rezultateve të hetimit të regjistruara me nr. {***} prot., datë 21.10.2019, f. 2.

⁴⁷ Referuar faqeve 33 dhe 34 të Rezultateve të Hetimit, pjesë e fashikullit të Komisionit.

krijuar pasuritë dhe për të kryer shpenzimet, nën dritën e analizës financiare për periudhën e referuar.

18.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur mjaftueshmëri burimesh financiare për të gjithë periudhën. Për këtë qëllim, ka depozituar në Komision një raport analize financiare të datës 22.10.2019, të kryer nga audituesi Sh. M.. Sipas këtij raporti, analiza financiare e çdo viti rezulton të jetë pozitive. Në ankim, subjekti i rivlerësimit potencon se, për sa kohë në vendimin përfundimtar të Komisionit nuk ka qartësi sesi është përfutur diferenca që ka thelluar balancën negative, vendimi nuk mund të vlerësohet si i drejtë e përbën cenim thelbësor të së drejtës së saj për t'u informuar⁴⁸. Mungesa e analizës financiare për secilin vit bën që të mungojë plotësisht arsytimi ligjor, argumenton subjekti. Fakti që balanca negative, [(-) 6.417.174 lekë], me të cilën është njohur vetëm me vendimin përfundimtar të Komisionit, nuk i është bërë me dije gjatë procesit, ka pamundësuar mbrojtjen nga ana e saj kundrejt konkluzioneve të dala rishtazi në mënyrë fillestare në vendim⁴⁹.

18.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi kreu një analizë mbështetur në analizën financiare me të cilën subjekti i rivlerësimit është njohur dhe ka pasur mundësinë të bëjë prapësimet e saj – *me rezultatet e hetimit administrativ* – konstatoi se konkluzioni i Komisionit se subjekti ka pasur pamjaftueshmëri burimesh financiare, për periudhën 2003-2016, është i drejtë dhe i bazuar. Për rrjedhojë, balanca negative financiare e konstatuar në Komision me rezultatet e hetimit u konfirmua edhe pas kontrollit të kryer në Kolegj. Nga verifikimi i kryer në Kolegj, mbi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, pas korrigjimeve për shkak të marrjes në konsideratë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për zëra të caktuar të analizës financiare, balanca negative e konstatuar në Komision me rezultatet e hetimit [në vlerën prej (-) 4.796.614 lekësh] u zvogëluar në (-) 4.045.623 lekë. Siç referohet më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e bazoi verifikimin në bilancin e konstatuar nga Komisioni me rezultatet e hetimit. Nga analiza financiare e kryer mbi bazën e akteve në fashikull, deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe metodologjisë së përdorur nga Kolegji për përlllogaritjen e shpenzimeve, balanca negative sipas këtyre zërave rezultoi më e thellë⁵⁰.

18.3. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, në konsideratë të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje disa aspekte me rëndësi. Së pari, pavarësisht se Komisioni është shprehur se shpenzimet e jetesës bazohen mbi standardin që INSTAT ka përcjellë ILDKPKI-së, për periudhën e viteve 2000 e në vazhdim, qoftë në rezultatet e hetimit, ashtu edhe në vendim, rezulton se për subjektin e rivlerësimit është përdorur një standard i ndryshëm. Konkretisht, siç rezulton qartë në faqen 33 të Rezultateve të Hetimit, Komisioni ka përfshirë *vetëm* 70% të shpenzimeve për periudhën 1995-2003 – në vlerën 1.578.780 lekë – ashtu siç në fakt ka kërkuar edhe subjekti i rivlerësimit, duke arsyetuar se Qarku Kukës ka shpenzime më të ulëta, *sipas metodologjisë së Komisionit*. Kjo metodologji nuk rezulton të referohet në një burim tjetër zyrtar, sikurse nuk rezulton të jetë rrjedhojë e metodologjisë së përcjellë ILDKPKI-së ndër vite, në funksion të analizës së kryer në zbatim të ligjit nr. 9049/2003⁵¹. Koncepti i reduktimit të shpenzimeve për qarqe të ndryshme nga Tirana nuk është i aplikueshëm në vlerësimin e konsoliduar, tashmë në gjithë vendimmarrjet e Kolegjit, për sa kohë bëhet fjalë për shpenzime minimale jetese. Me fjalë të tjera, Komisioni jo vetëm e

⁴⁸ Subjekti ngre dyshime nëse diferenca ka mbetur nga tabela e ndonjë vendimi tjetër apo është analizë e re për të cilën nuk është vendosur në dijeni.

⁴⁹ Faqe nr.10 e ankimit të subjektit të rivlerësimit.

⁵⁰ Nga analiza financiare në Kolegj, subjekti i rivlerësimit rezultoi në pamundësi të burimeve të ligjshme të të ardhurave për të krijuar pasuritë dhe për të kryer shpenzimet për periudhën 2003-2016, në vlerën prej (-) 9.455.706 lekësh, nga e cila vlera (-) 1.605.515 lekë është bilanci negativ që i përket periudhës 1992-2002, ndërsa vlera (-) 7.850.191 lekë është bilanci negativ që i përket periudhës 2003-2016.

⁵¹ Shkresa e ILDKPKI-së, datë 04.03.2019, nr. prot. {***}, drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, bashkëngjitur të cilës është përcjellë korrespondenca zyrtare e përvitshme e atij institucioni me INSTAT në vitet 2004-2018.

ka bazuar vendimin e tij në kërkesën e subjektit për shpenzime më të ulëta, por edhe ka referuar një metodologji të vetën për këtë qëllim.

18.4. Po ashtu, nga analiza e thelluar e kryer në Kolegj, vihet re se për vitet pas vitit 2003, Komisioni ka vendosur vlera më të larta se standardi i shpenzimeve të jetesës, sipas INSTAT/ILDKPKI për disa vite dhe vlera më të ulëta për disa të tjera. Kjo zgjedhje e Komisionit rezulton e pashpjeguar, e pa referuar në ndonjë dokument apo burim zyrtar, sikurse edhe e pashoqëruar me asnjë arsytim apo vlerësim të çfarëdo forme. Konkretisht, rezulton se Komisioni ka përzgjedhur vlera më të larta shpenzimesh jetese për pesë (5) vjet [2004, 2008-2009, 2013-2014] dhe vlera më të ulëta për katër (4) vjet të tjerë [2007, 2012, 2015-2016]. Në analizën e kryer në Kolegj, për këtë periudhë u vendosën vlerat e konfirmuara nga ILDKPKI-ja për shpenzimet e jetesës për një familje me katër persona, si standarde të vendosura, tashmë bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit. Nëse analiza financiare do të kryhej sipas standardit të përcjellë nga INSTAT, referuar më sipër dhe përdorur nga Kolegji, shpenzimet e jetesës do të shkonin në vlerën 2.203.015 lekë, për të njëjtën periudhë kohore⁵². Nën dritën e parimit të mospërkeqësimit të situatës së subjektit të rivlerësimit pas ankimit të ushtruar prej saj, në analizën e kryer në Kolegj në funksion të këtij vendimi, vlera e përdorur është ajo e përlogaritur nga Komisioni, që përbën në thelb një qasje me efekt favorizues për pozitën financiare të subjektit të rivlerësimit.

18.5. Në konsideratë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në analizën e kryer në Kolegj u përfshinë të ardhurat e dokumentuara të personit të lidhur për periudhën janar-mars 1995, në shumën prej 15.588 lekësh. Siç është përmendur edhe më sipër, në paragrafin 16.12, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi që për vitet 1992-1994, Komisioni ka përfshirë të ardhurat e bashkëshortit në vlerën 195.170 lekë, por nuk ka përfshirë shpenzime jetese, sikurse edhe shpenzime të tjera të ndodhura në këtë periudhë – si blerja e një apartamenti në Kukës në vitin 1994 dhe shpenzime mobilimi të deklaruara nga vetë subjekti i rivlerësimit – duke favorizuar situatën financiare të subjektit të rivlerësimit. Nëse do të konsideroheshin në analizën financiare shpenzimet e jetesës për periudhën 1992-1994, në kushtet kur janë përfshirë gjithë të ardhurat, shpenzimet totale të jetesës do të arrinin vlerën prej 2.267.145 lekësh, duke e rënduar pozitën e subjektit të rivlerësimit. Edhe këtë konstatim, trupi gjykues i Kolegjit e arsyeoi nën dritën e parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit në ankim, duke pranuar vlerësimin e Komisionit, ndonëse e gjen të pabazuar.

18.6. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se shpenzimet e udhëtimit jashtë shtetit, bazuar në të dhënat e sistemit elektronik të përdorur nga Policia e Shtetit [TIMS], janë llogaritur në vlera më të larta se për subjektet e tjera të rivlerësimit. Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, pas analizës së detajuar të kryer në Kolegj, rezultoi i pabazuar dhe i pambështetur. Një arsytimi i detajuar shtjellohet në vijim.

18.7. Në përgjigje të rezultateve paraprake të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar përlogaritjen e kryer nga Komisioni për shpenzimet e udhëtimit vetëm për vitet 2008 dhe 2012 dhe jo për vitet e tjera. Shpenzimet e udhëtimit të llogaritura ndër vite, [2005-2016], janë në totalin prej 1.942.731 lekësh [faqe 32 e rezultateve paraprake]. Në vendimin e Komisionit, përkundër sa përcjellë subjektit me rezultatet e hetimit, rezulton se totali i shpenzimeve për vitin 2008 midis dy analizave nuk ka ndryshuar, që nënkupton që pretendimet e subjektit në përgjigje

⁵² Shpenzimet e jetesës në Kolegj llogariten si vijon: për vitet deri në 1992 (përfshi vitin 1992), 100% e të ardhurave nga pagat; për vitet 1993-1999, 30% e të ardhurave nga paga; për vitin 2000, 9.000 lekë/muaj për person * 3 persona; për vitin 2001, 8.411 lekë/muaj për person*3 persona; për vitet 2002-2003, 7.822 lekë/muaj për person * numrin e personave në familje. Për shkak të inflacionit të lartë në vitet 90, shpenzimet janë përlogaritur në vlerën 100% të të ardhurave. Shih vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (JR) 14/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit A. Brati. <https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-dhe-mendimet-paralele-subjekti-i-rivleresimit-Alma-Brati.pdf>, referuar në jurisprudencën e Kolegjit edhe në çështjen (JR) 23/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit A. Shema, ndër të tjerë.

të rezultateve paraprake të hetimit nuk janë pranuar. Ndërkohë, për vitin 2012 rezulton se totali i shpenzimeve të pasqyruara në vendim është pakësuar me 94.244 lekë, në krahasim me shpenzimet për këtë vit në analizën financiare të rezultateve paraprake të hetimit. Për shkak se analizës në vendim i mungon arsyetimi, është e pamundur të konfirmohet ku bazohet ky ndryshim. Nga ana tjetër, nga analiza e paraqitur në vendim për vitin 2016, [gjatë analizimit të gjendjes *cash* në banesë], rezulton se Komisioni ka konsideruar një vlerë tjetër shpenzimesh për udhëtime, krahasuar me shpenzimet për këtë vit në analizën e rezultateve paraprake të hetimit⁵³. Ky pakësim as nuk është pretenduar nga subjekti as nuk është sqaruar nga Komisioni në vendim.

18.8. Konkretisht, në kuadër të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar llogaritjen e shpenzimeve për një udhëtim në Malin e Zi në vitin 2008 [80 euro apo 9.904 lekë, sipas subjektit të rivlerësimit, përkundër llogaritjes së Komisionit në vlerën prej 24.637 lekësh] dhe disa udhëtime në Greqi në vitin 2012 [55.836 lekë, sipas subjektit të rivlerësimit, përkundër llogaritjes së Komisionit në vlerën prej 264.071 lekësh]. Në analizën e kryer në Kolegj, bazuar në të njëjtën bazë zyrtare të dhënash [TIMS], u përlllogaritën shpenzime për katër netë [hyrja në datën 28.11.2008 dhe kthimi në datën 02.12.2008]. Për shpenzimet e udhëtimeve në Greqi në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se janë përballuar nga të afërmit⁵⁴.

18.9. Në përmbledhje, nga aktet e prodhuara nga Komisioni, është e pamundur të konfirmohet nëse qëndrojnë pretendimet e subjektit për përdorim koeficientësh më të lartë se subjektet e tjerë. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit, se përlllogaritjet e kryera nga Komisioni kanë qenë në disfavor të subjektit, u gjetën të pabazuara. Siç është referuar më sipër, në disa paragrafë të këtij arsyetimi, Komisioni rezulton të ketë favorizuar subjektin e rivlerësimit ndër të tjera, edhe me shpenzimet e udhëtimit. Vendimi i Komisionit, sikurse edhe rezultatet paraprake të hetimit datojnë në tetor dhe nëntor 2019, që nënkupton pasi është publikuar në faqen zyrtare të Kolegjit metodologjia e shpenzimeve të udhëtimit jashtë Shqipërisë, të cilat mund të ishin referuar nga Komisioni⁵⁵. Nëse do të konsideroheshin në analizën financiare shpenzimet e udhëtimit, sipas të dhënave nga TIMS, përlllogaritur sipas metodologjisë së përdorur nga Kolegji në jurisprudencën e tij, shpenzimet totale të udhëtimeve për periudhën 2005 – 2016 do të rezultonin më të larta dhe do të arrin vlerën prej 2.532.501 lekësh, duke e rënduar pozitën e subjektit të rivlerësimit. Nën dritën e parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues i Kolegjit konfirmon balancën negative të konstatuar nga Komisioni në rezultatet paraprake të hetimit edhe për këtë zë të shpenzimeve.

18.10. Pas analizës financiare të kryer në Kolegj nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, mbi bazën e zërave dhe analizës së përcjellë subjektit të rivlerësimit nga Komisioni me rezultatet e hetimit administrativ dhe në reflektim të shkaqeve të ankimit që u gjenden të bazuara, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi mungesë të burimeve të ligjshme të të ardhurave për të justifikuar krijimin e pasurive dhe për të kryer shpenzimet për vitet 2003 – 2016, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, në vlerën prej 4.045.623 lekësh, vlerë e përafërt me atë të konstatuar nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ. Kjo vlerë, rezultoi, pasi u morën në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, përlllogaritur në versionin më garantist të saj, në të cilën përfshihen vetëm zërat për të cilët subjekti i ka kaluar barra e provës nga Komisioni.

19. Për sa më sipër, pas shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit, që subjekti i rivlerësimit

⁵³ Shpenzimet e udhëtimit në analizën e rezultateve paraprake për vitin 2016 janë 354.407 lekë, ndërkohë në tabelën në faqen 27 të vendimit të anonimizuar, janë 302.509 lekë.

⁵⁴ Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratimet e të afërmeve, motrës dhe kunatit, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.08.2019, e D. L. dhe E. L.), sipas së cilëve shpenzimet janë përballuar prej tyre dhe se qëndrimi ka qenë në banesën e tyre.

⁵⁵ Shtjelluar në vendimin (JR) nr. 11/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit E. Islami. Publikuar edhe në <https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/E-Islamaj-vendim-i-anonimizuar-p%3%abr-web.pdf>

nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, është mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve që kanë rezultuar nga hetimi dhe në legjislacionin e zbatueshëm lidhur me to. Subjekti i rivlerësimit Hajrie Muçmata ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 209, datë 11.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Hajrie Muçmata.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 15.11.2022.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi